



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 18 datë 16/02/1998

**MBI**  
**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN DHJETOR**  
**1997.**

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi relacionin dhe projekt-vendimin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore.

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11445** familje me një fond prej **29.510.118** lekë.  
Për çdo njësi administrative sipas relacionit.
2. Të miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike **316** familje sipas pasqyrave përkatse.
4. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **88** familje sipas pasqyrës përkatëse.
5. Gëzim Koçi, Nj.A.3 të trajtohet në nivelin maksimal për familjet me 1 antar.
6. Të trajtohet si rast i veçantë për një periudhë prej 3 muajsh Qemal Kalo familje me 6 antarë në masën **5000** lekë në muaj, Nj.A.1.

7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1560** persona me aftësi të kufizuar dhe **70** persona për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsej prej **5.458.966** lekë.
8. Të miratohet kriteri për futjen në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve të reja dhe familjeve për rihyrje sipas procedurës përcaktuar në relacion.
9. Të trajtohen me ndihmë ekonomike 21 jetimë të strehuar në Qendrën e Formimit Profesional në nivelin maksimal për familjet me 1 antar me një fond prej **42.840** lekë.(shkresa Nr.384 prot.dt.11.02.1998 e APNSHS). Për zbatim njësisë administrative Nr.5.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**